



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 6.6.2022, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Pëllumbi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi dhe votimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural””, nismë e një deputeti. (*Komisioni përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Arben Pëllumbi, Helidon Bushati, Laert Duraj, Fadil Nasufi, Tatiana Piro, Luljeta Bozo, Ismet Beqiraj, Anduel Tahiraj, Ilir Ndraxhi, Baftjar Zeqaj, Benet Beci, Rrahman Rraja, Lefter Gështenja, Ramadan Likaj, Xhelal Mziu, Agron Duka, Nusret Avdulla dhe Ilir Pendavinji.

Mungojnë:

Flamur Hoxha, Fatjon Veizaj dhe Zef Hila.

Të ftuar:

Enio Civici – Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Irfan Tarelli – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Julinda Bare – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Erdion Maçolli – Përfaqësues i Komitetit Shqiptar të Helsinkit

Eduard Sharka – Kryetari i Sindikatës së Fermerëve

HAPET MBLEDHJA

Arben Pëllumbi – Mirëmëngjesi, kolegë!

Sot në rendin e ditës së Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin kemi shqyrtimin dhe votimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural””, për të cilin jemi komision përgjegjës dhe relator kemi deputetin Baftjar Zeqaj. Nisma është e kolegut tonë, zotit Duka.

Të ftuar kemi nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural zotin Enio Civici, zëvendësministër, zotin Irfan Tarelli, drejtor i Përgjithshëm i Politikave Bujqësore, ndërkohë nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit kemi zotin Erdion Maçolli dhe nga Sindikata e Fermerëve kemi kryetarin Eduard Sharka.

Mirë se erdhët!

Ky është një projektligj të cilin ne e kemi diskutuar në komision, zoti Duka ka bërë paraqitjen e tij dhe tani jemi në fazën, ku kemi një mendim nga të gjitha ministrinë e linjës për ta vazhduar shqyrtimin e tij deri në votimin përfundimtar.

Zoti Civici, do të flisni ju diçka?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëro, për procedurë!

Benet Beci – Më falni për ndërprerjen!

Duke u nisur edhe nga iniciativa e zotit Duka për këtë ligj, desha të sjell në vëmendjen tuaj, zoti kryetar, dhe të komisionit një ngjarje të rëndë, e cila ka ndodhur së fundi në qytetin e Fushë-Arrëzit, ku ka humbur jetën nëna me dy fëmijët, ngjarje për të cilën ju të gjithë jeni njoftuar dhe jeni të shqetësuar.

Nga verifikimet që bëmë javën e fundit, duket se tragjedia ka ndodhur për efekt të një problemi, goditjes së rrymës elektrike në këtë familje dhe mungesës së një pajisjeje shpëtimi, e cila quhet *salvavita*, që ka bërë të mundur të ndodhë kjo tragjedi.

Do të doja, në emër të komisionit, të kishim mundësi të ndërmerrnim nismën, si komision i Veprimtarive Prodhuese me dakordësinë edhe të opozitës, edhe tuajën, kryetar, për të parë mundësinë për të bërë një ndërhyrje ligjore për të bërë të mundur që të gjitha familjet të pajisen apo të kenë një pajisje të tillë të sigurisë elektrike, pse jo, të një financimi apo të institucioneve qendrore që janë përgjegjëse, pasi me një investim shumë të vogël ne mund të shpëtojmë shumë jetë, për një detyrim shumë të vogël të fëmijëve dhe të familjeve.

Mendoj se ky ka qenë një rast që ne ndoshta mund ta trajtojmë si komision për të marrë masën e duhur për një ndërhyrje që mund të shpëtojë shumë jetë dhe që nuk është një ndërhyrje shumë e vështirë.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Në fakt, meqenëse ju e prekët, është një ngjarje shumë e rëndë, madje nga ato për të cilat nuk gjenden as fjalët për të ngushëlluar, për më tepër kur fatkeqësia ndodh pa bërë asgjë, pa bërë asnjë lloj gabimi praktikisht.

Kështu, në këtë kuadër, edhe unë mendoj që ndoshta do të jetë një nismë e duhur nga ana jonë, por fillimisht le të mbledhim informacionin e nevojshëm se si mund të bëjmë të mundur që ta bëjmë detyruese, ndoshta, që në lidhjen e sahatit të energjisë elektrike të mos lidhen kontratat pa u pajisur edhe me një pajisje të tillë *salvavita*. Pastaj, mund të shikojmë mundësinë që ndoshta për familje të caktuara ose në nevojë apo në ndihmë ekonomike, nuk e di, qoftë edhe për ndonjë gamë tjetër familjesh të mund të bëhet e mundur të vendoset nga operatori apo nga dikush tjetër, se është shumë tragjike që sot të humbasin jetën kur ekziston një pajisje e tillë, e cila nuk ka as ndonjë kosto të madhe, ka një kosto minimale dhe të ndodhin fatkeqësi të tilla. Në një kohë moderne është shumë e pamundur.

Sigurisht, fatkeqësitë do të vazhdojnë të jenë, ato nuk parandalohen, por kur kemi mundësi të parandalojmë duke e parashikuar këtë gjë, besoj që edhe kolegët e tjerë nuk kanë pse të mos e përkrahin këtë iniciativë.

Zoti Beci, do ta kem në vëmendje propozimin tuaj, por të mbledhim informacion apo të shohim mundësinë se si mund ta adresojmë atë.

Zoti Civici.

Enio Civici – Faleminderit, zoti kryetar!

Fillimisht edhe unë, meqenëse ju po e diskutoni, dua t'u shpreh ngushëllimet e mia të gjithë familjarëve dhe të afërmve!

Lidhur me çështjen për të cilën ne jemi këtu sot, besoj se për çdo çështje teknike mund të përgjigjet drejtori i Përgjithshëm, zoti Tarelli.

Unë desha vetëm të vë në dukje faktin, që është i shprehur edhe në dokumente, edhe në përgjigjen nga Këshilli i Ministrave, se ne do të përmbylim brenda dy muajve të ardhshëm strategjinë 2021-2027, e cila konsideron shumë çështje dhe nga e cila do të duhet edhe të rishikojmë sadopak ligjin e vitit 2007.

Dëshirojmë që ndryshimet t'i bëjmë në mënyrë uniforme, njëkohësisht duke pasqyruar të gjitha kërkesat e tregut, të fermerëve apo edhe të grupeve të tjera të interesit.

Prandaj edhe dëshirojmë që në atë moment t'i rishikojmë dhe t'i shqyrtojmë ndryshimet e mundshme.

Arben Pëllumbi – Zoti Civici, ju falënderoj!

Meqenëse ju e prekët këtë punën e strategjisë që po ndërtoni dhe përpara fillimit të kësaj mbledhjeje ka pasur edhe një diskutim me kolegët tanë, do të dëshiroja dhe do t'ju kërkoja që një grup kolegësh të përfshihen në strategjinë që ju po ndërtoni, të jenë në dijeni dhe të ndihmojnë me mendimet e tyre, sepse, në bazë të asaj strategjie, pastaj do të vijë edhe i gjithë kuadri ligjor që do të kalojë në këtë komision.

Kështu që paraprakisht do të doja që pjesë e ndërtimit të strategjisë të jenë edhe disa nga kolegët e këtij komisioni, në mënyrë që në të ardhmen mund të jenë edhe relatorë të projektligjeve që ju do të paraqisni.

Meqenëse kjo është edhe një kërkesë e vazhdueshme që ne i kemi bërë si qeverisë, por edhe secilës prej ministrive të linjës që ne mbulojmë, do të donim që edhe në projektligjet që ju do të filloni të ndërtoni, relatori i komisionit të jetë pjesë e diskutimeve paraprake, pra të mos paraqitet në komision projektligji pa qenë në dijeni relatori i çështjes, i cili, në rast se do ta ndjekë në vazhdimësi ndërtimin dhe strukturimin e projektligjit, konsultimet që zhvillohen, sigurisht, do të jetë shumë në dijeni dhe në brendësi të tij edhe për ta mbrojtur, edhe për të na sqaruar të gjithë ne të tjerëve.

Kështu që, meqenëse jemi duke folur për strategjinë, do të doja që te strategjia të bëhet e mundur që disa nga kolegët tanë, të cilët janë ndoshta edhe më ekspertë të fushës, të mund të jenë pjesë e diskutimeve për të.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ramdan Likaj – Meqenëse zëvendësministri i Bujqësisë është këtu, unë mora një informacion nga zonat tona veriore që të gjitha eksportet që bëhen për pjesën e Europës janë bërë në Hanin e Hotit.

Tani, për një arsye arbitrare mund ta quaj, të gjitha eksportet do të vijnë në Durrës, të skanohen aty dhe të rikthehen prapë. Pra, kërkesa e të gjithë eksportuesve është që kjo gjë të hiqet sa më shpejt, pasi është e pamundur. Ka një rritje të jashtëzakonshme për sa u përket transporteve.

Unë bëra një telefonatë me zëvendës drejtorin e Përgjithshëm të Doganave dhe ai më informoi se kjo gjë është absolutisht absurde, ka ardhur si kërkesë e drejtorit të Përgjithshëm të Kufirit për një arsye që paska ndodhur para disa kohëve të një importi që është bërë me bimë medicinale për Shqipërinë. Tani kjo situatë i ka rritur transportet jashtëzakonisht shumë.

Pra, imagjinoni të vijë një eksport në Durrës, të skanohet dhe të rikthehet përsëri. E kuptoni? Të lëvizë për në Kroaci e me radhë, deri në Gjermani, në Francë e kudo. Ai më kërkoi që këtë shqetësim ta ngremë, sepse është absolutisht absurde. Edhe ata janë dakord, pasi e hasin përditë. Më tha se kanë kërkuar ndihmë nga qeveria për vendosjen e një skaneri në doganën e Hanit të Hotit, por deri në këtë moment ka qenë e pamundur.

Pra, kjo është një kërkesë e vazhdueshme e eksportuesve. Kështu që ne jemi edhe komisioni përkatës dhe besoj se kjo gjë duhet të zgjidhet sa më shpejt, se është një dëm jo i vogël ekonomik edhe në situatën që kalojnë eksportuesit shqiptarë, po të imagjinoni se si është transporti sot.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Likaj!

Zoti Zëvendësministër, në qoftë se është e mundur, ndiqeni pak këtë çështje. Nëse do t'ju duhet edhe ndihma jonë, në mënyrë të padiskutuar, por me sa po kuptoj është çështja e skanerit që në Hanin e Hotit nuk ka një të tillë dhe, me sa duket, kufiri kërkon që kontejnerët me bimë medicinale të skanohen dhe për këtë arsye i dërgojnë në Durrës.

Megjithatë, do të duhet gjetur një zgjidhje, sepse, me të drejtë, sidomos edhe sot në kushtet e rritjes së lartë të çmimit të karburantit, një shtesë e tillë transporti incidon në mënyrë të drejtpërdrejtë te kostot e atij produkti dhe shton shpenzime të tepërta për bizneset.

Edhe ju, edhe unë jemi të ndjeshëm ndaj këtij aspekti. Kështu që do t'ju lutesha nëse keni mundësi që çfarëdolloj informacioni ta ndani edhe me ne. Në qoftë se do t'ju duhet ndihmë edhe nga ana jonë, të na thoni që edhe ne të bëjmë detyrën tonë.

Faleminderit!

Zoti Tarelli, do të thoshit diçka më shumë për kolegët, meqenëse ka kaluar edhe njëfarë kohe nga momenti kur ne e kemi diskutuar?

Irfan Tarelli – Faleminderit, zoti kryetar!

Ne e kemi parë me shumë vëmendje draftin e propozuar, por, siç u tha edhe nga zëvendësministri, e kemi trajtuar në kuadrin e të gjithë strategjisë që tashmë është përgatitur. Pra, kemi një dokument të përgatitur, edhe me konsulencë ndërkombëtare, të Strategjisë së Zhvillimit të Bujqësisë deri në vitin 2027, ndërkohë e kemi parë edhe në një kuadër tjetër më të gjerë të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim që ka afatin 2030, sepse efektet e këtij ligji janë shumë të rëndësishme dhe supozojnë implikime në periudha të gjata kohore.

Duke thënë këtë, përveç çështjeve që adreson projektligji, ne kemi evidentuar edhe disa çështje të tjera që kanë nevojë të rishikohen, sidomos në kuadrin e angazhimeve që burojnë nga integrimi europian. Ligji i bujqësisë dhe i zhvillim rural prek në mënyrë të

drejtpërdrejtë kapitullin 11 “Bujqësia dhe zhvillimi rural” të *acquis communautaire* dhe, përveç çështjeve të mbështetjes drejtpërdrejt të fermerëve, ka edhe një kuadër rregullator më të gjerë që, në gjykimin tonë, ligji aktual për bujqësinë dhe zhvillimin rural, i miratuar në vitin 2007, nuk i adreson në mënyrë të plotë dhe në mënyrë të integruar.

Për këtë arsye ne kemi mbajtur qëndrimin që ndërhyrjet në këtë ligj të bëhen edhe në këndvështrimin perspektiv, si dhe të pasqyrojnë edhe elemente të tjera.

Pastaj, për çështje konkrete kemi pasur objeksionet tona që lidhen, së pari, në mënyrën se si trajtohen amendimet e shkëputura për implikimet financiare dhe për implikimet e natyrave të tjera, për të cilat kemi dërguar komentet tona në Këshillin e Ministrave. Tjetër gjë që desha të theksoj është që qëndrimet e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Drejtësisë shkojnë në të njëjtën linjë me qëndrimin e pavarur të mbajtur nga ministria në ministri. Kjo do të thotë se rikonfirmojmë pozicionet tona.

Ministria e Financave, që është edhe shqetësimi ynë, kërkon që projektligji të ishte i shoqëruar, në fakt, edhe me një pasqyrë të efekteve financiare, sepse, nëse merret detyrimi në ligj, pra pa asnjë kushtëzim në subvencionet ndaj fermerëve, natyrisht që prodhon edhe efekte të mëdha financiare; aspekti i parë.

E dyta, nëse pranohet, po themi, një paketë e pandryshuar për afatin 5-vjeçar, në fakt, projeksionet e buxhetit të shtetit me ligjin organik të buxhetit, pra buxheti afatmesëm është deri në 3 vjet. Pra, kërkon edhe një sërë ndërhyrjesh ose konsiderimesh në kuadër dhe në harmoni me ligje të tjera.

Ky ishte në përgjithësi komenti që ne kemi bërë për projektligjin.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Tarelli!

Zoti Baftjar, kishit diçka?

Baftjar Zeqaj – Ministria e Bujqësisë gjatë dy muajve do të merrej seriozisht me ligjin e vjetër të bujqësisë.

Në përgjithësi, si bllok qëndrimesh qëndrojnë ato që ka propozuar zoti Duka. Besoj se ai ka qenë në kontakt ose ka dëgjuar edhe zhvillimet e grupeve të interesit. Pra, në përgjithësi qëndrojnë të gjitha shqetësimet që besoj se do të ngurtësohen në ligjin që po hartohet ose, thënë ndryshe, në strategjinë e zhvillimit të bujqësisë.

Unë, për shembull, jam pak entuziast që ky dymuajsh do të jetë intensiv për bujqësinë, sepse vetë përfaqësoj një zonë bujqësore dhe do të përpiqem të jem shumë aktiv me grupet e interesit dhe, njëkohësisht, me Ministrinë e Bujqësisë, me qëllim që ne të mos jemi vetëm në këtë bllok shqetësimesh, që e ritheksoj është shumë i drejtë, por edhe në problematikat e tjera që ka sot bujqësia.

Ju, zoti kryetar, e thatë, por unë dua ta ritheksoj se do të ketë një koordinim më të mirë të punëve ndërmjet grupit tonë, që është grupi më i rëndësishëm në hartimin e kësaj strategjie, dhe Ministrisë së Bujqësisë ose një grupi që ministria ka ndërtuar për hartimin e kësaj strategjie. Kjo që thashë është në parim, por më konkretisht ne duhet të kemi merakun që të gjithë njerëzit që përfaqësojnë një grup interesi të fushës së bujqësisë duhet ta kenë thënë fjalën e tyre. Pra, duhet të komunikohet në njëfarë mënyre qoftë nga Ministria e Bujqësisë apo nga komisioni ynë, në qoftë se do të kemi një bashkëpunim shumë të mirë që pas dy muajsh ne ose specialistët e bujqësisë, ose grupet e interesit t'i kenë thënë të gjitha dhe mendimi i tyre të jetë përfshirë, duke i thënë "Të shkuara, të harruara" këtij ligji, ngaqë është i vjetër domethënë dhe ne do të hartojmë një strategji.

Sa më shumë të komunikojmë me njerëzit dhe specialistët e bujqësisë, pse jo, edhe me fermerët atje ku dhemb, domethënë, me ata që sot prodhojnë, aq më mirë do të hartohet dhe me këmbë në tokë një strategji.

Nuk e lexova materialin, por pothuajse u thanë gjërat.

Kështu besoj se edhe zoti Duka është dakord me këto mendime.

2 muaj nuk janë shumë...

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Zeqaj!

Zoti Duka.

Agron Duka – Faleminderit!

Tani unë këtë nuk e kam bërë vetë njëherë, por e kam bërë në konsultë me grupet e interesit, me sindikatat e fermerëve dhe duke u konsultuar me ta. Ndër këta është edhe njëri nga ata që unë mendoj se, gjithashtu, duhet ta dëgjojmë.

Parimisht jam shumë dakord me ju që gjërat duhet të shkojnë në kohezion, po themi, që gjitha këto lloj ndryshimesh nesër të jenë të përfshira në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Bujqësisë, e cila parashikon një periudhë kohore shumë më të gjatë.

Problemi është se situata në bujqësi sot ka shumë probleme dhe nuk di: a na pret koha neve të ndjekim të gjitha etapat burokratike, të cilat do të ishin shumë më mirë nëse ne do të ndërhyjmë menjëherë?

Tani, jo sipas meje, por sipas atyre që merren me bujqësi, fermerëve dhe sipas grupit të interesit, gjithçka sa parashikoni në këtë projektligj nuk ka ndonjë ndikim të ndjeshëm në shpenzime, e para.

E dyta, për një gjë duhet të jemi të sigurt, që, duke na përfshirë edhe neve që jemi këtu në këtë tavolinë, zotin Ramadan dhe unë që merremi direkt ndoshta me bujqësi vetë ose jemi marrë, absolutisht, nuk mund të pretendojmë se e njohim dhe na dhemb aq shumë, qoftë

edhe ne të dyve, se gjithsesi kemi edhe biznese të tjera, po flas shumë sinqerisht... Madje-madje atë biznesin që kishte ky për bujqësinë, e mbante ai tjetri, ai industrial, se të ishte për bujqësinë është shumë e vështirë, janë dhënë edhe më shumë se ata që janë atje në terren.

Prandaj, unë mendoj se ne që jemi këtu në opozitë, jo për faktin se jemi në opozitë, por edhe ju që jeni maxhorancë, për faktin se jeni në maxhorancë dhe e keni në dorë për ta bërë këtë punë, duhet t'i shikoni pak më me sensibilitet problemet e bujqësisë, sepse bujqësia shqiptare vuan dhe ka shumë probleme.

Ndër to janë këto që ne kemi paraqitur te ky lloj projektligji.

Nëse doni, i lexojmë një për një, por e kemi bërë njëherë këtë, domethënë, siç janë: subvencionet direkte, që ju nuk i keni pranuar asnjëherë, nuk i pranoni, nuk e di, ndoshta nuk e keni as koncept t'i pranoni. Madje, unë habitem se, mirë ato që e shohin nga larg, po ata që janë në zona rurale nuk e kuptojnë që nuk mund të zhvillohet bujqësia me projekte të selektuara nga AZHBR-ja për njerëz, të cilët janë pak më të aftë apo kanë mbaruar edhe ndonjë gjysmë shkolle dhe dinë të aplikojnë? Sepse ne e dimë që me bujqësinë merret rreth mbi 40% e popullatës, nga të cilët nuk është se i kemi shumë të shkolluar. Madje-madje, ankohemi edhe për këta që e mbarojnë Institutin Bujqësor, ku fakultetet dhe klasat janë bërë me nga 5-6 studentë.

Në këto kushte, ata po nuk patën njeri që t'i asistojë, t'u japë edhe ndonjë lek, se kështu funksionojnë këto punë: nuk dinë të aplikojnë dhe nuk përfitojnë...

Prandaj ne kemi ngulur këmbë dhe do të këmbëngulim gjithmonë që njerëzit, që të merren me bujqësi, duhet të subvencionohen pavarësisht se kanë aplikuar ose jo te kjo AZHBR-ja. Projekti që merret nga AZHBR-ja është diçka shtesë, që i ka e gjithë bota dhe shumë mirë, madje, unë kam folur fjalë të mira dhe jo vetëm unë, sepse janë gjëra evidente. Për shembull, IPARD-i është disbursuar 100%. Rast i rrallë. Bravo i qoftë! Shumë mirë kanë bërë, por problemi është: po ato që nuk aplikojnë te këto programe, si ia bëjnë?

Një pikë që kemi ngritur ne aty, se këto janë të gjitha pa...

Domethënë, kjo e para kërkon njëfarë shpenzimi dhe, natyrisht, mund të parashikohet në buxhetin e ardhshëm. Po kjo tjetra? Domethënë, nuk është se kërkon ndonjë shpenzim, siç është bërja e analizës së tokës edhe të ujit. Domethënë, tokat tona kultivohen monokulturë, ndonjëherë jashtë çdo lloji rregulli. Po ta krahasojmë me organizmin e njeriut, është njësoj si një mjek që e kuron një njeri për grip, ndërkohë që është me kancer. E njëjta histori ndodh edhe me tokën, njerëzit nuk e dinë se çfarë përbërje ka toka e tyre dhe e mbjellin me një kulturë që ajo tokë nuk e prodhon. Them që këtë e kemi si një sëmundje të vazhdueshme, pavarësisht se ka një shërbim *ekstensionit*. Faktikisht, le ta thonë edhe ekspertët që janë këtu,

shumica e njerëzve që merren me bujqësi nuk e dinë se për çfarë është e përshtatshme toka e tyre. Ne patjetër duhet t'i orientojmë edhe për ujin, edhe për tokën, gjë për cilën duhet të presim strategjinë kombëtare të zhvillimit të bujqësisë.

Gjithashtu, dua të flas edhe për diskriminimin që u bëhet njerëzve. Çfarë shpenzimesh do të kërkojë kjo gjë, ma thoni pak? Domethënë, i bëhet diskriminim një njeriu që ka 5 lopë apo dikush që ka sipërfaqe të vogël toke merr pak pikë për të aplikuar tek AZHBR-ja, ose nuk i jepet fare mundësia. Pra, bëhet diskriminim, në mënyrë që të bëhet shoqërizimi i pronave, dhe që të krijohen shoqatat e fermerëve. Jam dakord, por mos bëni diskriminim negativ, bëjeni pozitiv.

Folëm edhe herën e kaluar për incentivat, politikat nxitëse, shtytëse, por jo t'i themi fermerit: “Po nuk u bashkove me ferma të mëdha, ty s'të jap fare subvencion”. Ai thotë: “Kaq mundësi kam. 5 lopë mund të mbaj”. Ato lopët nganjëherë i mbajnë brenda oborrit të shtëpisë, ndonjëherë flenë edhe me to. Edhe i themi fermerit që, s'të japim gjë, sepse duhet të bashkohesh me ferma të mëdha me 50 lopë blegtoje, që të japim subvencion. Po ai s'ka mundësi.

Dakord jam, atyre që janë bashkuar në ferma të mëdha, t'u japim më shumë. Pra, bëni diskriminim pozitiv, jo negativ. Çfarë shpenzimi kërkon përjashtimi i këtyre njerëzve? Ata janë shumica e bujqësisë shqiptare, dhe të tjera si këto që nuk mbarojnë.

Unë nuk jam dakord me argumentin që: jemi duke bërë strategjinë kombëtare dhe nuk bëjmë ndryshime në ligjin për bujqësinë. Ky ligj është i pandryshuar që nga viti 2007, ka 15 vjet. Kjo çështja e ndryshimit të ligjit ka një vit që është shtruar, por nëse do të shtrohej para 3 ose 4 vjetësh, çfarë do të thoshit ju? Të njëjtin argument do të përdornit, prisni 4 -5 vjet të tjera, se ne do të fillojmë përpilimin e strategjisë kombëtare të zhvillimit të bujqësisë? Në qoftë se ky lloj projektligj do të vinte para 5 vjetësh (se ju keni 9 vjet në pushtet dhe kush e di kur ikni), prapë me këtë histori do të vazhdonit, duke thënë: të presim, sepse do të bëhet strategjinë kombëtare e zhvillimit të bujqësisë?

(Ndërrhyrje pa mikrofon nga salla.)

S'e kam me ty, e kam fjalën për politikën që ndiqen. Ty ashtu të kanë thënë të flasësh, ashtu ke folur.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Duka!

Po, zoti Sharka.

Eduard Sharka – *(Flet pa mikrofon)* ...edhe të Këshillit të Ministrave, edhe të Ministrisë së Bujqësisë, edhe të Ministrisë së Drejtësisë, edhe të Ministrisë së Financave.

Unë dua ta nis duke i kthyer një përgjigje zotit Gështenja, sepse në seancën ku u diskutuan këto gjëra na tha se ligji ekzistues nuk pengon të realizohen të gjitha propozime që kemi bërë dhe bëhen ose me vendim të Këshillit të Ministrave, ose me udhëzim të Ministrisë së Bujqësisë. Ne erdhëm deri këtu, sepse donim të shfrytëzonim vullnetin e ligjvënësit për ta detyruar, sepse ne ia kishim çuar këto kërkesa me shkrim Ministrisë së Bujqësisë, Kryeministrisë; kishim dalë edhe në protesta, pra i kishim ezuaruar të gjitha format e ligjshme të sensibilizimit për t'i zgjidhur këto probleme, kështu që e fundit ishte ardhja në Parlament. Morëm parasysh edhe modelin e Maqedonisë, që të gjitha i ka të shkruara në mënyrë eksplicite në ligj, ku urdhëron Këshillin e Ministrave dhe ministrin për disa probleme kryesore.

Kthehem te përgjigja.

E para, unë nuk e di si mund ta pranoni ju si deputetë, si ligjvënës që Ministria e Bujqësisë të thotë: në vitin 2022, se është bërë strategjia 2021-2027. Të paktën, Këshilli i Ministrave ta kishte hequr vitin 2021, të thoshte vetëm vitin 2027, sepse të bësh strategji për dy vjet që kanë kaluar, për vitin 2021 dhe vitin 2022 mua më duket absurde.

E dyta, zoti Duka e tha që nuk ka shpenzime ekonomike dhe i vetmi shpenzim është ai i analizave, që për 20 000 analiza nga 5000 lekë, që e kishte nxjerrë Ministria e Bujqësisë koston, janë 200 milionë lekë ose rreth 1 milion euro. Këto shpenzime nuk duhet të dalin në mënyrë ekzoficio nga buxheti i shtetit, por të gjenden në fondet e Ministrisë së Bujqësisë, nga rigrupimi.

Më kryesorja që dua të them, që nuk pret, është se skemat ekzistuese që po aplikohen sot janë diskriminuese për fermerët. Për vitin 2022 kanë aplikuar 6000 fermerë për përfitimet në blegtori dhe fondi mjafton vetëm për 3000, vija e kuqe është te numri 3000. Të gjithë i plotësojnë kushtet dhe i vetmi kriter që ndan përfituesit nga jopërfituesit është minutazhi, koha e aplikimit. Ndërsa, propozimi ynë është që më mirë të bëhet një skemë e studiuar, që të përfitojnë të gjithë fermerët e mundshëm dhe të aplikohet një skemë dhe jo dy skema, sepse ai fond më mirë të çohet atje ku e shikon qeveria apo Ministria e Bujqësisë prioritet më të domosdoshëm sesa të krijohen diskriminime midis fermerëve me fonde të huaja. Kjo gjë nuk pret ndonjë strategji. Edhe që ta dini, ky lloj kriteri vlerësimi për të dhënë subvencione nuk ndodh në asnjë vend të rajonit dhe të Europës, dhe as ky lloj diskriminimi që u bëhet fermerëve.

E njëjta gjë është edhe për skemën e naftës. Kanë aplikuar rreth 55 000 fermerë dhe deri tani janë përpunuar dosjet që janë dorëzuar deri në datën 9 mars, ndërkohë që afati i aplikimit ka qenë deri më 25 prill. Besoj se nuk do të përfitojnë as gjysma e atyre që kanë

aplikuar. Gjithë propozimi ynë ka qenë për të parandaluar këtë fenomen, që të mos ketë diskriminim të fermerëve.

Dua të them një gjë për Ministrinë e Bujqësisë, nuk e di ku e gjejnë kurajën kur thonë: “Vendimi i Këshillit të Ministrave përcakton kriteret, kurse udhëzimi nuk i përcakton”. Po të shikojmë vendimin nr.101 të Këshillit të Ministrave, i cili përcakton masat për të përfituar nga subvencionet e këtij viti edhe udhëzimet është krejt e kundërta. Kriteret përcaktohen në udhëzimin e ministrit të Financave dhe ministrit të Bujqësisë, ndërsa Këshilli i Ministrave përcakton vetëm masat që përfitojnë, masat 1, 2, 3 deri në 7 dhe fondet përkatëse. Pra, është e kundërta në realitet. Propozimi ynë ishte që t’i hiqet ministrit të radhës së Bujqësisë e drejta për të bërë këto kritere, të cilat për ne janë diskriminuese. Rasti konkret është kur kemi 2000 hektarë sera, fondi u planifikua për 2000 hektarë sera, që të përfitonin 400 mijë për dynym. Kanë aplikuar 50% e fermerëve, sepse kriteri ishte që duhet të kishe mbi 1 hektar serë, ndërkohë që 95% e fermerëve kanë nën 1 hektar sera. Justifikimi ishte që ky kriter nxit kooperimin, por ne kemi qindra argumente që ky kriter nuk e nxit kooperimin, përkundrazi është një kriter diskriminues për ata që përfitojnë.

Brenda kësaj linje, Ministria e Bujqësisë, jashtë udhëzimit ka sajuar udhëzime të tjera, ku u kërkon fatura fermerëve pasi kanë aplikuar, kanë bërë dhe vetëdeklaratën për të vërtetuar 1 hektar serë, u thotë që duhet të kenë blerë të njëjtin fidan apo të njëjtën farë. Ndërkohë, edhe një fermer i vetëm, me 3 dynym serë, gjysmën e mbjell domate, gjysmën e mbjell specia. Kriteri i Ministrisë së Bujqësisë është që duhet ta ketë të mbjellë me të njëjtën kulturë. Edhe këtu përjashtohen fermerët, sepse gjysma e tyre nuk e përfitojnë. Ky është realiteti dhe këtë gjë kemi dashur ta parandalojmë, duke ju kërkuar juve që me vullnetin tuaj të detyroni qeverinë dhe Ministrinë e Bujqësisë të heqë dorë nga këto kritere diskriminuese, të cilat nuk janë në favor të fermerëve. Kaq e thjeshtë është.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Sharka!

Zoti Tarelli, a keni diçka për të thënë?

Irfan Tarelli – Zoti kryetar, kam përshtypjen se kemi një parashtrim jo korrekt në raport me çfarë përcakton ligji i bujqësisë dhe i zhvillimit rural; çfarë ka atribut Këshilli i Ministrave për të vendosur në zbatim të ligjit dhe çfarë atributi kanë ministri i Bujqësisë dhe ministri i Financave. Ligji thotë qartësisht se vendimi i Këshillit të Ministrave përcakton kriteret bazë, dhe kriteret bazë janë emërtimi i masës dhe intensiteti i mbështetjes. Është e pamundur (dhe nuk është praktikë shqiptare, por është praktikë e çdo vendi që aplikon skema të tilla mbështetëse) që në një vendim të Këshillit të Ministrave të përcaktohen kriteret

specifike që janë objekt i udhëzimit, kushtet e të tjera. Pra, nëse kemi një numër të caktuar masash mbështetëse, nga pikëpamja e teknikes legislative, por edhe nga pikëpamja përmabjtësore, nuk mund të parashtrohen të gjitha në një vendim të Këshillit të Ministrave. Për këtë arsye, vendimi i Këshillit të Ministrave u delegon ministrave përkatës të përcaktojnë kriteret specifike, që natyrisht nuk bien ndesh me principin, me thelbin e ligjit. Kjo është një praktikë e konsoliduar, të paktën prej 17, 18 vjetësh dhe një interpretim i tillë mua nuk më duket i përshtatshëm dhe korrekt.

Për sa i përket pjesës së dytë, kriteret specifike nuk janë kufizime, diskriminime dhe përjashtime, por që kur miratohet fondi në buxhetin e shtetit ka një limit të caktuar dhe do të ishte shumë më e papërshtatshme që ne të rrisnim pritshmërinë e të gjithë fermerëve dhe në fund të skualifikonim në varësi të fondit në dispozicion. E thënë me fjalë të thjeshta, Ministria e Bujqësisë me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, me udhëzimin, do të shpërndajë aq burime financiare sa ka në dispozicion, në këtë kuptim nuk konsiderohet diskriminim ndaj një grupi ose një tjetri.

Për shembull, përmendet faktori kohë, natyrisht kur ke një numër të caktuar aplikimesh që përmbushin kushtet, por fondi është i limituar; je i detyruar të vësh një kriter që nuk është diskriminues për asnjërin, mund të jetë kriter kohor, mund të jetë kriter madhësie mund të jetë kriter sipërfaqeje e të tjera. Në qoftë se bëjmë një koment të përgjithshëm për të gjitha propozimet, po të hyjmë në detaje, parashikimi ligjor nuk e zgjidh këtë gjë, por e zgjidh një mekanizëm tjetër, që është fondi në dispozicion. Kur themi që po i trajtojmë në mënyrë të integruar me strategjinë, këtë kemi parasys. Pra, do të harmonizojmë qëndrimin që do të mbajë qeveria shqiptare nëpërmjet miratimit të strategjisë dhe do të pranojmë pagesat direkt për sipërfaqe ose njësi prodhimi, siç është praktika e Bashkimit European. Ky është qëndrimi strategjik, pastaj do të shqyrtohet dhe do të përkthehet në ligj; ose do të ketë qëndrim tjetër në raport me burimet në dispozicion, por në raport edhe me disa gjëra të tjera.

Në qoftë se më lejoni zoti kryetar, do të bëj edhe një parashtrim të shkurtër, në emër të një ekspertize të qëndrueshme në Ministrinë e Bujqësisë. Ne ende sot e kësaj dite, për shkaqe objektive nuk kemi definicionin “fermer”. Pra, ka një çështje konceptuale: fermer do të quhet cilado ekonomi bujqësore që kemi sot apo do të pranojmë edhe në legjislacion, edhe në dokumente të tjera të natyrës politike-ekonomike, një definicion të caktuar në raport me qëndrimet e Bashkimit European apo të organizatave të tjera ndërkombëtare? Kjo lidhet detyrimisht edhe me përfitimin ose jo të subvencionit. Por kemi edhe një dimension tjetër të politikave të zhvillimit, pra subvencionet direkt në raport me mbështetjen, me investimet

duhet të jenë në proporcion X. Ne kemi pranuar, të paktën në draftin e strategjisë, që të unifikojmë qëndrimet tona me politikën e përbashkët bujqësore të Bashkimit European dhe me politikën e përbashkët të peshkimit. Peshkimi është një dimension i cili, gjithashtu, mungon në ligjin për bujqësinë dhe zhvillimin rural, që kërkon edhe një rregullim në koncepte për agjencinë e pagesave. Pra, janë një sërë çështjesh të tjera më konceptuale për t'u zgjidhur.

Nga ana tjetër, ka edhe probleme të natyrës infrastrukturore, sepse përfitimi i një numri shumë të madh fermerësh nuk mund të bëhet me metodat e zakonshme, me kontrollin e drejtpërdrejtë në fermë që ne zbatojmë sot. Këto janë edhe qëndrimet e strategjisë të mbështetura me projekte që i kemi aktualisht, që të kalojmë në një fazë digjitalizimi të bujqësisë, në të kundërtën nuk do të gjenim një mekanizëm efektiv të shpërndarjes së subvencioneve në mënyrë efektive dhe pa abuzime. Pra, çështja është më komplekse se kaq. Kur themi që ndryshimet në ligjin për bujqësinë dhe zhvillimin rural mendojmë t'i kemi të harmonizuara me strategjinë, nuk kemi qëndrime taktike t'i shtyjmë një muaj, t'i shtyjmë dy muaj. Jo, qëndrimi është konceptual. Në këtë kuptim ne nuk kemi neglizhuar aspak, përkundrazi i kemi parë me shumë seriozitet të gjitha propozimet, sepse ato paraqesin shqetësimet reale të komuniteteve; mendojmë se kjo është zgjidhja më e mirë. Nuk do të fitonim asgjë në qoftë se do të bënim një ndryshim në çdo dy muaj, sepse edhe ligji aktual nuk na pengon të shtojmë subvencionet, nëse buxheti i shtetit ka hapësira ose tavane të mtejshme për të rritur subvencionet. Formulimi që është në ligjin aktual nuk pengon që Këshilli i Ministrave të përcaktojë kriteret dhe të tjera, por vënia e detyrimit 5-vjeçar apo vendosja e të gjitha kategorive është e lidhur edhe me këtë lloj vizioni, me këtë lloj qëndrimi dhe harmonizimi, me praktikatat më të mira që zbatohen sot në vendet e Bashkimit European.

Ky është komenti im për sa u diskutua më lart.

Arben Pëllumbi – Zoti Tarrelli, faleminderit!

Në fakt, marr shkas edhe nga ajo që tha zoti Sharku, si po funksionon sot rimbursimi i karburantit?

Irfan Tarelli - Rimbursimi i karburantit deri në momentin që po flasim...

Enio Civici – Do ta jap unë përgjigjen për këtë pyetje, sepse jam marrë me këtë pjesë.

Dua t'u them se vjet kanë aplikuar mbi 26 mijë fermerë dhe i kanë përfituar litrat e naftës rreth 19 mijë. Këtë vit kanë aplikuar mbi 50 mijë fermerë. Pra, që në numrin e aplikimeve kemi dyfishin dhe brenda datës 2 qershor u janë shpërndarë rimbursimet pothuajse 20 mijë fermerëve. Kryesisht këta janë fermerët që do të mbillnin kulturat pranverore, pra që u duhej nafta më shpejt se të tjerëve. Që në këtë periudhë kemi dhënë pak

më shumë se vjet dhe po vazhdojmë të japim edhe pjesën e dytë. Uroj që të kemi edhe më shumë fonde, në mënyrë që t'i plotësojmë të gjithë fermerët pa asnjë përjashtim. Për këtë po punojmë për ditë, edhe me qeverinë.

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Zoti Bushati.

Helidon Bushati – Atëherë, do të filloj nga fakti që zoti Duka i ka bërë këto propozime për ndryshime ligjore në bashkëpunim të ngushtë me shoqatën e fermerëve dhe me Komitetin e Helsinkit. Në diskutimin e përfaqësuesve të Ministrisë së Bujqësisë kishte një qëndrim, ku u dallua fryma për ta hedhur poshtë nismën. Pra, u kuptua qartë se kjo nuk kërkon ndonjë filozofi të madhe. Sidoqoftë pyetjet e mia kanë lidhje me diçka substanciale. Ju kaluat në argumente të tipit: “..do të bëjmë strategjinë, do të bëjmë edhe paketën ligjore”. Bashkë me strategjinë, thatë që s’keni fonde, domethënë, folët për mungesën e fondeve.

Unë si pjesëtar i këtij komisioni, dua një qëndrim për sa u përket pikave që ka propozuar deputeti Duka së bashku me shoqatën e fermerëve: qëndrojnë apo nuk qëndrojnë? Sepse, nëse zëvendësministri tani më thotë që do të plotësohen nevojat e të gjithë aplikantëve për rimbursimin me karburant, atëherë, pse të mos plotësohen edhe nevojat në varësi të drejtimeve strategjike 5-vjeçare të parashikuara në ndryshimet ligjore? Kuptohet, për disa së paku, jo për të gjitha, se pa dyshim fondet nuk janë të palimituara. Pyetja ime është: për këto 5 pika, nga ana profesionale (pastaj te pjesa e fondeve është diçka tjetër, nuk ju takon, ndoshta duhet të jetë Ministria e Financave ose qeveria që të shprehet), konceptualisht qëndron të kemi drejtime 5-vjeçare, për të treguar qartë se ku do të shkojmë me mbështetjen e këtyre sektorëve të ndryshëm apo elementeve të veçanta të bujqësisë? E para.

E dyta. A jeni dakord apo jo që fondet të shkojnë te “njësia prodhuese”, siç e quani ju? Se ne themi: për krerë dhe për sipërfaqet e mbjella. Këto janë gjëra konceptuale. A jeni konceptualisht dakord që të ekzistojë një strukturë, e cila të bëjë balancimin e tregut, duke marrë aksesin e prodhimit të tepërt dhe duke e shpërndarë sipas metodologjisë së parashikuar?

Ndërsa, pjesa e diplomacisë bujqësore është diçka që nuk ka impakt shumë të madh, sepse ka tregtarë që duhet ta mbulojnë vetë këtë pjesë. Kjo është diçka që varet më shumë nga ju si ministri, që t’u ofroni informacione në formë broshurash apo informacione sektoriale për potencialet e zhvillimit. Dua të di, këto 3 pikat e para që janë edhe më kryesoret, ju konceptualisht, jeni kundër tyre apo do të presim që këto 3 pika të jenë pjesë e ligjit, së paku pasi të diskutohet edhe strategjia? Unë jam dakord të bëhen që tani, por

hipotetikusht, nga ana juaj si ministri: cili është qëndrimi ndaj këtyre 3 pikave kryesore të parashikuara në draftin e paraqitur nga deputeti Duka?

Arben Pëllumbi – Zoti Tarrelli, në fakt, ju keni dhënë një përgjigje me shkrim, por gjithsesi në respekt të pyetjeve të zotit Bushati, mund të përgjigjeni.

Irfan Tarrelli - Ne jemi munduar t'i sqarojmë edhe me shkrim, ato pika bëhen pjesë e një trajtimi më të përgjithshëm sesa ndërhyrjet e fragmentuara në ligj, sepse gjykojmë që nuk bëjmë më të mirën e mundshme. Ndërhyrja vetëm me dy-tre elemente, pa e plotësuar me të gjithë paketën e plotë, nuk do të ishte zgjidhja më e mirë. Ky është qëndrimi ynë. Pra, konsiderohen në raport me qëndrimin e strategjisë.

Përveç kësaj, unë u mundova të them se ka edhe disa elemente të tjera, që kërkojnë shqyrtim të mëtejshëm. Për shembull, nëse ne pranojmë në ligj një paketë të pandryshuar për 5 vjet, ajo kërkohet të harmonizohet me PBA-në, që është 3 vjet. Pra, në një ligj për bujqësinë ne nuk mund të marrim këtë angazhim, kur projeksioni për buxhetin e shtetit është vetëm 3-vjeçar. Kjo kërkon një shqyrtim më të thelluar edhe me Ministrinë e Financave.

E dyta, projekt-propozimi nuk ka paketën financiare. Paketa financiare është një element shumë thelbësor para se të mbash definicione dhe qëndrime të tjera të prera në ligj.

E treta, në gjykimin tonë, këto nuk janë propozime tërësore që shkojnë me paketën që aplikohet sot në vendet e Bashkimit Europian, ndërsa qëndrimi në draft-strategji është më i plotë sesa kaq.

Kjo është përgjigja jonë.

Arben Pëllumbi - Faleminderit!

Po, zoti Mziu.

Xhelal Mziu – Projektligji i paraqitur sot vjen në një moment shumë të volitshëm për të gjetur zgjidhjen. Jam absolutisht i pakënaqur me angazhimin që në krye të herës në këtë takim të dy përfaqësuesve të Ministrisë për ta bërë nul këtë iniciativë.

Para disa ditësh Organizata Botërore e Ushqimit publikoi një statistikë për vendet e Ballkanit dhe mesataren e Bashkimit Europian. Shqetësimi kryesor që kjo organizatë ngrinte, duke e shoqëruar edhe me një grafik, ishte mbështetja e drejtpërdrejtë. E para, për mbështetjen totale Shqipëria ishte sa gjysma e vendit më të ulët të Ballkanit dhe e dyta, në raport me Bashkimin Europian ishte 11 herë më pak nga totali.

Shqetësimi që ngrinte Organizata Botërore e Ushqimit ose FAO, kishte të bënte kryesisht me mbështetjen e drejtpërdrejtë. Po ta shikosh grafikun, Shqipëria jep mbështetje të drejtpërdrejtë vetëm 3 euro për hektar, kurse pjesa tjetër është 42 euro për hektar, që do të thotë se shumica e saj është 45 euro për hektar.

Bosnjë-Hercegovina jep 60 euro për hektar mbështetje të drejtpërdrejtë dhe totali është 66 euro. Pra, 10 nga 11 pjesë të totalit jepej mbështetje e drejtpërdrejtë.

Kosova jep 69 euro për hektar mbështetje të drejtpërdrejtë dhe totali i mbështetjes, bashkë me atë që jep qeveria, shkon 133 euro.

Maqedonia e Veriut jep 143 euro për hektar, pra, ne japim 3 euro, kurse ata 143 euro, dhe totali i mbështetjes shkon 196 euro për hektar.

Për t'iu referuar Bashkimit Europian, mbështetja e drejtpërdrejtë për fermerët ishte 274 euro dhe totali 446 euro. Pra, në raport me rajonin, mbështetja e drejtpërdrejtë ndaj fermerëve është 20 herë më pak, në raport me totalin është 2-3 herë më pak sesa rajoni, kurse në raport me Bashkimin Europian është 11 herë më pak. Kjo është statistika më e qartë për të treguar situatën e bujqësisë sot.

Ajo që thotë zëvendësministri: “mos na pengoni në hartimin e planit 5-vjeçar 2022-2027”, tregon edhe një herë angazhimin, që jo vetëm nuk është e nevojshme të punosh ditën e dielë, por mjafton të punojë qeveria 1 ditë në javë për të qenë koherente me një strategji bashkëkohore që ne kemi sot. Madje, po ta shikosh, Organizata Botërore thotë se mbështetja informale që Shqipëria ka bërë është një nga shkaqet pse ka ndodhur shpopullimi i zonave rurale të Shqipërisë.

Duke qenë deputet i Dibrës, dua të flas për Dibrën. Fushat e Dibrës konsiderohen si Myzeqeja e Veriut. Po të shkosh atje sot, duke filluar nga fushat e Maqellarës, të Kastriotit, Fushë – Aliaj, të Brezhdanit, Muhurrit, të Gjoricës, të Shupenzës, mbi 90 e kësaj sipërfaqeje është djerrë, sepse nuk ka mbështetje.

Unë isha një ditë në Dibër dhe pashë se një kilogram qershi shitej me 200 lekë, ndërkohë që në tregun e Tiranës shitet me 1 000 – 1500 lekë. Pra, një fermer, që bën gjithë ato shpenzime, e shet një kilogram qershi vetëm 200 lekë të vjetra. Shumica prej tyre e hedhin prodhimin, sepse nuk kanë një mbështetje.

Ndërkohë, nëse shkon në Dibrën e Madhe, qershitë mbështeten, nuk ka firo. Do të thotë se propozimi i bërë nga kolegu Duka është absolutisht vetëm shumë pak nga ajo që ne duhet të bëjmë. Marr shkas edhe nga bërja e strategjisë. Unë nuk e kuptoj pse bëjmë strategji dhe rimë pafundësisht duke shpenzuar kohë me fjalë boshe?

Pse nuk marrim shembull një nga vendet e rajonit? Merrni kë të doni, vendin që ju e konsideroni më të volitshëm: merrni Malin e Zi që jep 2 herë më shumë sesa ne, merrni Kosovën që jep 3 herë më shumë sesa ne, merrni Maqedoninë që jep 4 herë më shumë sesa ne, merrni Bosnjë-Hercegovinën që jep 2,5 herë më shumë sesa ne, jo vetëm në total, por mbështetje të drejtpërdrejtë.

Madje, Organizata Botërore e Ushqimit thotë se në Shqipëri 42 eurot për hektarë jepen në mënyrë të qëllimshme nga institucionet e tjera, për t'u futur në kalvarin e burokracive dhe për të përdorur instrumente të tjera, të cilat nuk shkojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë te fermeri. Pra, edhe një herë, që Shqipëria të mos e rrënojë bujqësinë, siç e kemi sot, që të mos shpopullohet dhe të mos ngelet djerrë, duhet të rritet mbështetja e drejtpërdrejtë për hektarë dhe e dyta, të rritet edhe totali i saj.

Jo vetëm aq, por vetë Organizata Botërore e Ushqimit shkruan: “Që një vend të pranohet në Bashkimin Europian duhet që, minimalisht, 1/3-n e asaj që kërkon, ta mbështesë nga buxheti i saj. Sot Shqipëria ka shifër mjerane mbështetjeje për bujqësinë dhe që ajo të shkojë në standardin që kërkohet, duhet të japë 190-200 milionë euro që të plotësojë kushtet e vendeve të rajonit, që janë kandidatë për në Bashkimin Europian”.

Në datat 23 dhe 24 prill të vitit të shkuar Ministria e Bujqësisë rendte me patronazhistët për të shpërndarë tollonat e naftës një ditë para zgjedhjeve. Nuk po merrem shumë me këtë pjesë, sepse uroj që të jetë e kaluar, por unë dua të vendos theksin: e para, fermerët shqiptarë të trajtohen njëjloj si ata të rajonit; e dyta, t'u jepet mbështetje e drejtpërdrejtë dhe e treta, të mos themi: mbaroi fondi. Unë nuk e kuptoj si mbaron fondi? Pse mbaron fondi?

Pra, një shtet vendosë se do të përfitojnë kaq për hektarë dhe jo kush e zë radhën i pari, aq më tepër që radha bëhet evazive.

E dyta, Shqipëria, në dallim nga vendet e tjera, jo për faj të fermerëve, i ka parcelat e copëtuara. Pse të persekutohet dikush që, ose është copëtuar për shkak të ligjit nr.7501, ose është në zonat e thella dhe aq kapacitet ka për të mbajtur bujqësi, blegtori apo frutikulturë?

Një pjesë e mirë e këtyre që unë thashë janë parashkruar në këto ndryshime që kërkohen, ndaj unë do të kërkoj, që jo vetëm këto që thashë unë, por sidomos ato që janë në projektligj, duke iu referuar edhe shqetësimit që ngre Organizata Botërore e Ushqimit, të merrni eksperiencën e vendeve rajonale dhe bëjini të denjë edhe fermerët shqiptarë.

Është absurditet që në Dibër 70-80 e sipërfaqes së tokës së punueshme është djerrë dhe që qershitë, patatet, mollët dhe kumbullat hidhen poshtë se nuk i mbledh kush. Kjo është situata që ne kemi.

Uroj dhe shpresoj që qëndrimi juaj të jetë objektiv, bashkëkohor, teknik dhe i unifikuar me rajonin dhe me Bashkimin Europian, atje ku ne tentojmë të shkojmë sa më shpejt.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Mziu!

Urdhëro, zoti Duka.

Agron Duka - Faleminderit!

Unë nuk marr përsipër të konkurroj Irfanin, sepse ka kaç vjet që merret me hartimin e këtyre projektligjeve, rregullave dhe ndoshta i di më mirë se unë, por me dashamirësi i them: “ i lexoni objektivat kryesore për të cilat ky projektligj është bërë”. Thuhet: “Objektivat kryesore që synohet të arrihen, përfshirë një mbështetje jo më pak se 5 vjet në sektor e të tjera”. Ju thoni se afati 5 vjet ka një ngërç për arsye se projekt-buxheti nuk parashikohet për 5 vjetët e ardhshme. Dakord, nëse është kështu, koncepti është që investimet të jenë afatgjata për shkak edhe të interesit që kanë njerëzit, që merren me bujqësi edhe 1 vit.

Për këtë arsye, kur ta parashikoni, nëse ky lloj ngërçi nuk ju lejon, atëherë shikoni një afat pak më të madh sesa 1 vit, sepse për 1 vit interesi është shumë i ulët, sidomos në një fushë si bujqësia apo agro-përpunuesit. Një agro-përpunues për 1 vit nuk shikon asgjë në dritë. Kështu që, në këtë sens unë ju them: shikojeni. Pastaj, ne mendojmë që me diskriminimin që ju mendoni se nuk mund të përfshihet e gjithë fasha e njerëzve që aplikojnë aty, duhet patjetër, sepse e tillë është evidenca dhe e tillë është gjendja e bujqësisë shqiptare. Kur bëjmë diçka, një copë letër, një ligj ose si të duash quaje ti, ne duhet të nisemi nga fakti ose produkti që duam të arrijmë.

Unë nuk them që nuk kemi arritur asgjë, se në 30 vjet bujqësia ka arritur shumë ndryshime: ka ndryshime në rendimente, në koncept, në përdorimin e pesticideve e të tjera, por kemi edhe shumë probleme dhe nuk jemi aty ku duhet të shkojmë.

Ndërmjet të tjerave, ne mendojmë ndërhyrje për të rregulluar tregun në rast të krijimit të stoqeve për arsye objektive.

A kemi këtë fakt? Po, e kemi. Për shembull, në pandemi ne nuk dinim ku të çonim prodhimin. Faktin që thotë Xhelali ne e kemi, nuk është se e ka pasur vetëm kjo qeveri, por edhe qeveria ku kam qenë unë, edhe qeveritë e PD-së. Ka pasur raste superprodhimi, por ne nuk po arrijmë t'i kalojmë dot. Ka 30 vjet që ne krijojmë ligje, ndërhyjmë, por nuk po arrijmë dot të themi ...

Dakord, ky është rast që ka dalë njëri në facebook dhe thotë: kush do qershi, le të vijë t'i vjelë vet, se nuk kam ku i çoj, por ne po na ndodhin shumë raste. Njerëzit po hedhin prodhimin, ndoshta edhe prej politikave të gabuara të qeverive tona. Nuk e kam fjalën për këtë qeveri që është, por në përgjithësi për qeveritë tona, përfshirë edhe ne.

Ndoshta ndodh edhe për fajin e politikave fiskale, TVSH-së e të tjera (rasti që derdhin qumështin), por edhe për shkak të politikave të gabuara në orientimin e fermerëve dhe për

sqarimin e rasteve kur ka mbiprodhim. Këtu ka një propozim konkret që këta kanë bërë bashkë me mua.

Miratimi i projektligjit fuqizon dhe zhvillon konceptin e ndërhyrjes për stabilizimin e tregjeve. Këtu ne mendojmë të ketë një agjenci. Çfarë ka këtu? Nuk ka as shpenzime, asgjë të keqe.

Ne e kemi këtë problem prej 30 vjetësh.

E para, sa herë vjen një ministër i ri thotë: “Unë do të bëj rajonizimin e kulturave bujqësore”. Çfarë do të thotë? Do t’i orientoj fermerët çfarë të mbjellin. Por nuk po e bëjmë dot. Gjenerali një mënyrë.

Këta kanë një propozim konkret: të krijojmë një agjenci që merret me këtë punë dhe t’i thotë fermerit: këtu mos mbill këtë kulturë, sepse nuk ka leverdi për shkak të tokës, ujit e të tjera, por qoftë edhe tregut që ta orientojë. Këtu kanë futur edhe punën e ambasadave, që të mundohen të gjejnë tregje.

Domethënë, është një gjë e kontrolluar me sens pozitiv.

Është kollaj të thuash: këtu jam kundër.

Unë e shikoj si problematikë kur thuhet: “kjo nuk bëhet”, “kjo nuk bëhet”, “kjo nuk bëhet”. Ne kemi këto halle në bujqësi dhe ne i shikojmë dhe i takojmë përditë. Nuk është vetëm për shkak të kësaj qeverie, por ka 30 vjet që nuk po i zgjidhim, përveç atyre që kanë ecur. Ato që kanë ecur, kanë ecur.

Në fusha ka rendimente të mëdha, por ne e kemi në raport me rajonin: me Maqedoninë, me Kosovën, pa llogaritur vendet shumë të zhvilluara, ku ne duam të shkojmë. Kemi shumë probleme.

Nuk i them këto për të thënë që kjo qeveri e zezë nuk ka ditur t’i bëjë, sepse të vijë ustai që di t’i bëjë këto reklamat, do të thotë: sa turp, ku ka qenë dhe ku është.

Faktikisht, këto probleme që unë thashë këtu kanë qenë dhe këtu janë.

Arben Pëllumbi - Faleminderit, zoti Duka!

Po, zoti Civici!

Enio Civici – Unë po e nis fillimisht nga fjalimi i zotit Duka, me të cilin jam dakord që propozimet qëndrojnë dhe mund të aplikohen pastaj me të gjithë filozofinë e asaj strategjie që themi ne. Mbështetja disavjeçare është pjesë e strategjisë. Pra, pavarësisht nëse është 3 vjet, sipas projektbuxhetit afatmesëm, apo është 1, 2 apo 10 vjet, në strategji është paracaktuar dhe menduar që politikat mbështetëse të jenë disavjeçare, jo vetëm 12-mujore.

Lidhur me mbiprodhimin apo më tej, rajonizimin e prodhimit dhe informacionin mbi fermerët për kulturat që duhet të mbillen dhe pastaj të dalin në treg, këtë proces, në vitet e

fundit, përveç shërbimeve të eksensionit që janë patjetër aty për të gjithë fermerët, po e bëjnë edhe pikat e grumbullimit, të cilat janë mbështetur nga qeveria shqiptare dhe është një realitet i pamohueshëm. Janë mbi 250 prej tyre vetëm në 4 vjetët e fundit, që operojnë dhe të cilat komunikojnë me tregun, me blerësit atje, për t'i thënë çfarë kërkon tregu. Nga ky moment fermeri e di se çfarë duhet të mbjellë, e di se cilin produkt të tij do të kërkojë tregu dhe ai do ta shesë. Për ata pak fermerë, të cilët nuk janë të orientuar, patjetër jemi dakord që do të duhet të orientohen edhe më tej.

Ndërsa, në lidhje me fjalën e zotit Mziu, të cilin unë e kuptoj që ka një qëndrim politik, më duhet t'i kujtoj ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më lejoni ta mbaroj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po, e kam lexuar dhe shqyrtuar, por nëse më lë ta mbaroj ndoshta më kupton çfarë dua të them.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi - Zoti Mziu, pa diskutim që zëvendësministri është politik dhe do të mbajë qëndrime politike. Megjithatë, dinim edhe ne t'ju ndërhyjmë në fjalën tuaj, sepse nuk jemi dakord fare me ato që thatë, por megjithatë ju lamë ta mbaronit fjalën. Ju i thatë të gjitha çfarë donit të thoshit si i mendoni ju, edhe nëse janë apo jo të drejta.

Lejoni zëvendësministrin t'ju japë një përgjigje dhe nuk ka pse të mërzhiteni me përgjigjen që ai do të japë, ashtu siç nuk u mërzhit ai me parashtrimin që bëtë ju.

Enio Civici – Unë jam shumë dakord me zotin Mziu dhe e falenderoj që ky diskutim po bëhet në këtë komision, por dua t'i kujtoj se ai raport apo grafik, të cilit zoti Mziu i referohet, në fund të tij shkruhet “nga viti 2011-2018”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Mziu, 2011-2018.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më lejo ta mbaroj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti kryetar, mund ta mbaroj?

Është një grafik që tregon mbështetjen nga viti 2011 deri 2018. Nga viti 2018 e këtej mbështetja është shumë e qartë. Po marr vetëm rastin e disbursimit të fondeve europiane nga IPARD-i, duke u shkrirë me ato të buxhetit të shtetit, sepse ato janë 100%. IPARD II-i është disbursuar 100%, si një rast suksesi për Shqipërinë. Për këtë mjafton t'ju them se me IPARD

III-in, pra, fondin e ardhshëm, nga 92 milionë euro, të cilat ishin mbështetja e fundit, tashmë bashkë me kontributin e qeverisë shqiptare do të jetë 146 milionë euro.

Kur Bashkimi European mendon se duhet të na e rrisë mbështetjen për fermerët, sepse e kemi shfrytëzuar në mënyrën e drejtë, mendoj se njësoj duhet ta shikojmë edhe ne. Patjetër që ka vend për përmirësim dhe gjithmonë do të ketë.

Më lejoni të them edhe një gjë të fundit lidhur me strategjinë. Ajo është patjetër e konsultuar me ekspertët ndërkombëtarë, me grupet e interesit dhe vazhdon të jetë e tillë edhe në këto momente që po flasim. Do ta shtojmë patjetër edhe kërkesën që ju na dhatë në fillim të kësaj seance, që anëtarët e këtij komisioni bashkë me të gjithë dijen dhe informacionin shumë të vlefshëm që kanë nga grupet e interesit, të jenë pjesë e përfundimit total të strategjisë.

Arben Pëllumbi - Faleminderit, zoti Civici!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, një minutë, zoti Mziu!

Në fakt, personalisht besoj se ne që kemi një jetë që jetojmë çdo ditë në këtë vend dhe që nga mëngjesi në darkë impenjohemi me problemet dhe shqetësimet e këtij vendi, duhet të mbështetemi më shumë në atë që dimë vetë, në atë që dëgjojmë vetë, në atë që bëjmë vetë sesa në disa statistika dhe grafikë, që shpeshherë kanë edhe burime jo të sakta informacioni.

Këtu në këtë tryezë ka burra dhe gra, të cilët kanë vite të tëra që impenjohen në sektorët përkatës. Unë nuk i heq asnjë presje eksperiencës që ka zoti Duka në këtë sektor, që ka zoti Lika në këtë sektor, apo kolegë të tjerë dhe shumë më shumë më intereson mendimi i një specialisti të tillë sesa një grafiku të FAO-s apo dikujt tjetër, së pari.

Së dyti, kur marrim dhe bëjmë krahasime të shpenzimeve buxhetore për vende të ndryshme duhet të kemi parasysh që çdo vend ka specifikat e veta, qoftë në të ardhura, qoftë në shpenzime. Në qoftë se dëshirojmë të bëjmë një krahasim të tillë duhet të krahasojmë të gjithë zërat e buxhetit. Në rast se kapim një zë buxheti në mënyrë të padiskutuar ato s'përputhen asnjëherë, një është më pak një është më shumë.

Për sa i përket çështjeve të superprodimit, kur diku kemi të tilla, pa diskutim na ndodhin, është çështje rakordimi, është çështje njohurish, është dhe çështje që duhet të jenë të qartë për atë që bëjnë, sepse deri më sot unë nuk kam dëgjuar që ne të kemi një superprodhim të mandarinës. Kjo ndodh pikërisht se në atë sektor njerëzit janë organizuar siç duhet, prodhohet aq sa tregtohet dhe dihet me saktësi sesi do të veprohet. Pra atje ku ka një organizim të caktuar të saktë, prodhimi është ai që është dhe njerëzit marrin të ardhurat e tyre. Këtë shembull suksesi ne duhet ta materializojmë edhe në sektorë të tjerë, sepse ne nuk i

heqim dot asnjë presje faktit që kemi edhe mbiprodhim të qershisë, shumë mirë që kemi prodhim shumë, por duhet t'i gjejmë treg asaj qershisë, apo edhe mollës, të cilës duhet t'i gjejmë treg. Ne kemi bërë një debat të gjatë në lidhje me mollën edhe me prodhues të caktuar të zonës së Peshkopisë, të cilët sugjerojnë zonat e Korçës që të ndërrojnë llojin e mollës, ta shartojnë dhe ta kthejnë në mollë Fixhi, sepse ajo është molla që ecën sot dhe jo molla e famshme e Korçës, të cilën nuk e do njeri. Politika të tilla sigurisht janë politika, të cilat ju i zbatoni, por ne këtu sot jemi për disa propozime konkrete, që janë të bëra nga zoti Duka. Sigurisht ne e dimë që në ato propozime ka gjëra racionale, sepse edhe sindikata e fermerëve është një organizim, i cili është ditë për ditë aty në treg dhe ndeshet me hallet, problemet dhe shqetësimet që kanë ata qytetarë, ata fermerë dhe ata banorë. Unë i qëndroj edhe një ideje tjetër, që ne të gjithë bashkë duhet që ekonominë bujqësore të mos e shikojmë si një ekonomi lëmoshe, të cilën do të duhet ta subvencionojmë vetëm për të mbijetuar, por duhet ta kthejmë në një ekonomi, e cila prodhon mirëqenie për ata që veprojnë në atë sektor. Ndoshta mekanizmat që kemi pasur deri tani nuk janë aq rezultative sa duhen, në mënyrë që t'i bashkuar njerëzit përtej mentalitetit. Ndoshta duhet të eksplorojmë forma të tjera dhe në rast se ne nuk kemi bashkim, jo bashkim mekanik me zor, sepse edhe ky po na rezulton që nuk bëhet dot kaq kollaj, duke i detyruar ata që të bashkohen bashkë për të marrë subvencione, pasi disa zona mund ta bëjnë, disa zona të tjera mund të mos e bëjnë dot, por pa u zgjeruar sipërfaqja prodhuese, pa u zgjeruar edhe koncepti i fermerit, kë do të quajmë fermer të jemi të saktë edhe me këtë gjë, sepse fermer me 200 metra katror tokë, që mbjell vetëm domate s`mund të quhet fermer, por është një fshatar në kushtet e mbijetesës, të gjitha këto bashkë nuk heqin asnjë presje shqetësimeve që ne kemi.

Propozimet e zotit Duka kanë gjetur një përkrahje edhe në këtë komision, edhe propozimet e sindikatës së fermerëve, të materializuara pastaj nga Komiteti i Helsinkit në formën e një projektligji. Kështu që unë kam, edhe në cilësinë e kryetarit të këtij komisioni kam gjetur një lloj dakordësie edhe nga ministria, edhe nga Këshilli i Ministrave që një pjesë e këtyre propozimeve do të merren parasysh në ligjin e ri për bujqësinë, që ju do të hartoni pasi të mbarojë strategjia. Pra do të doja të ishim të qartë që ne nuk është se nuk jemi dakord me disa nga këto propozime, por momenti në të cilin ndodhemi nuk na lejon që të bëjmë një ndryshim në ligjin për bujqësinë, i cili me të drejtë, siç tha zoti Duka, ka 15 vjet që nuk është prekur ndërkohë që bujqësia ka lëvizur dhe është transformuar, por ligji i ri i bujqësisë duhet të marrë parasysh edhe disa skema të tilla, ose propozime të tilla dhe në mënyrë të veçantë strategjia duhet të jetë që këto shqetësime, qoftë dhe kjo e financimeve 12 mujore, të mund të marrë një lloj zgjidhjeje. Unë ngelem gjithmonë i idesë që ne duhet ta mendojmë edhe

bujqësinë si entitet ekonomik, pra, që të prodhojë mirëqenie dhe jo thjesht të bëjë të mbijetojnë ata njerëz që merren me bujqësi, që, për hir të se vërtetës, janë edhe individët, të cilët lodhen më shumë, po ta marrësh përgjegjësi pune, volumi pune në raport me të ardhurat, se të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë shqiptare.

Po, zoti Mziu.

Xhelal Mziu – Më vjen mirë që zëvendësministri qenka i azhurnuar me shqetësimin e FAO-s, ndërkohë i kujtoj zotit Civici që duhet ta lexojë grafikun mirë.

Së pari, Shqipëria për vitin 2018 ka 42 euro, vetëm 3 në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe mesataren që ai thotë. Shqipëria nga viti 2011 deri në vitin 2018 e ka...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, por duhet të dish ta deshifrosh. I ke të dyja, mund të ta jap një kopje ta kesh. Mesatarja e viteve 2011-2018 është vetëm 31 euro, për 2018 është vetëm 45 euro.

Duke marrë shkas edhe nga kryetari që thotë duhet të shohim specifikat, unë nuk e kuptoj çfarë specifikash duhet të shohim kur vendet e rajonit e kanë 2-3 herë më shumë sesa ne. Mirë se nuk e shohim specifikën e çmimit të naftës ose akcizën apo TVSH-në, po bujqësinë, Sepse thotë euro për hektarë mbështetje nga buxheti i shteti dhe te mbështetja thuhet sa do të jetë e drejtpërdrejtë dhe sa duhet të jetë nëpërmjet institucioneve, të cilat i quan institucione burokratike, që, në fakt, nuk shkon atje ku duhet.

Për të vazhduar me produktet që ne kemi, nuk besoj se luan rol lloji i mollës apo lloji i qershisë, por luan rol mbështetja e drejtpërdrejtë dhe konkurrenca me vendet rajonale të këtyre fermerëve.

Shqetësimi kryesor i yni dhe i kujtdo, nuk e shoh në aspektin politik, sepse e njëjta gjë mund të ndodhte edhe kur ministër ishte zoti Duka, edhe kur ishte PD-ja edhe sot, por ne themi: që të shkojmë drejt vendeve të Bashkimit Evropian, ne, minimalisht, të barazohemi me ato të rajonit, pra, ta mbështesim bujqësinë që të mos shpopullohetm të mos ngelet toka djerrë dhe të rritet paga mesatare, aq më tepër që bujqësia te ne zë një peshë të konsiderueshme për shkak të potencialit që ajo ka.

Arben Pëllumbi– Faleminderit zoti Mziu!

Në fakt, dua t’ju bëj një sugjerim. Të paktën, kur kemi zotin Civici përballë, ku mund të bëjmë debat me të në lidhje me nevojën e plehrave kimikë apo të ekstensionit, mos u “ha” me të, sepse ka vite të tëra që grafikët i ka forcën e tij më të madhe.

Zoti Lika, fjala për ju.

Ramadan Lika- Unë nuk i heq asnjë pikë e asnjë presje të gjitha atyre që tha zoti Duka. Ato janë të domosdoshme për t’u përfshirë në këtë ligj.

Lidhur me sqarimin që edhe zëvendësministri dha, duke qenë se e njoh mirë fushën e bujqësisë, ne jemi të përditshëm me fermerët dhe, sigurisht që ne dimë shumë më mirë se kushdo tjetër se ku janë hallet, problematikat dhe shqetësimet sot dhe në të ardhmen.

Unë mendoj se të gjitha ato që u parashtruan nga zoti Duka janë të domosdoshme. Dëgjuam që thatë se ka pika grumbullimi që i orientojnë vetë fermerët, sigurisht që këto pika grumbullimi ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk e di se sa bëjnë realisht, sepse nuk mendoj se shumë pika grumbullimi i kanë kapacitetet e duhura për të orientuar fermerët në të gjithë Shqipërinë. Unë flas për zonën, të cilën mbuloj, që është një nga zonat më të rëndësishme sot për kultivimin e bimëve medicinale dhe aromatike, që është Malësia e Madhe, e cila është ndër furnizuesit kryesorë me lëndë të para për të gjithë eksportuesit e Shqipërisë. Sot unë e shoh si shqetësim të përditshëm dhe në mënyrë të veçantë për të ardhmen sa i përket kësaj fushe. Në qoftë se në vitet në vazhdim, ose në mënyrë të veçantë në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, nuk arrijmë të mbështesin fermerët me makineri bujqësore, orientuese për atë fushë, unë mendoj se për 3-4 vjet sasi të do të bien në mënyrë drastike. Ky është një dëm jo thjesht për disa biznese, por është një dëm i madh për të gjithë fermerët që merren me këtë punë dhe e kanë të lidhur ekonominë e tyre të përditshme. E them këtë, sepse gjatë 30 vjetëve të gjitha punimet, ose pjesa më e madhe, është bërë nga fuqia punëtore, e cila ka qenë e lirë, ndërsa, nga viti në vit, kjo po bie çdo ditë dhe, në dy vitet e fundit ne kemi parë në mënyrë drastike që korrjet e prodhimeve të bimëve fillojnë sot, sepse nuk ka fuqi punëtore. Duke e parë këtë situatë shqetësuese, kjo është edhe ndihmë për Ministrinë e Bujqësisë nesër, ne jemi të detyruar, si eksportues të kësaj fushe, të gjejmë mekanizma sesi kjo fushë duhet të ecë dhe duhet të ruaj këto sasi prodhimi edhe për të ardhmen. Ky nuk është dëm vetëm për ne, por edhe eksportet në Shqipëri. Ne, si prodhues dhe eksportues të këtyre bimëve, po punojmë prej dy vjetësh me ekspertë ndërkombëtarë, pse jo me inxhinierë të mirëfilltë me kooperim, edhe me inxhinierë amerikanë e europianë, të cilët i kemi sjellë edhe në parcela të zonave tona të paktën, ku këto dy vjetët e fundit kemi paguar jashtëzakonisht shumë dhe vazhdojmë të paguajmë derisa ne të arrijmë të gjejmë se cilat janë makineritë e duhura bujqësore për t'i orientuar në këtë fushë. Mendoj se jemi drejt zgjidhjes përfundimtare dhe besoj se brenda pak muajsh do të jenë edhe makineritë e para që do të implementojnë në atë zonë. Çfarë dua të them me këtë?! Së pari, ato janë toka shumë gurishtore dhe puna e parë që do të bëhet aty është një makineri që po prodhohet enkas për atë zonë nga një grup kooperues kompanish europiane, gjithmonë nën mbikëqyrjen e inxhinierëve amerikanë, ku do të bëjmë provat e para nga muaji shtator.

Shpresoj, në baze të orientimit që kemi, që deri këtu është më sukses. Makinaria e parë është pa lëviz gurin nga toka, sigurisht s'ke ku ta çosh, sespe do investime shumë të mëdha, prodhohet një makineri që këtë gur ta spostojmë në punime deri në 30-35 centimetër, ta zhysim, dhe të gjitha kultivimet që do të bëhen për këtë produkt, ky gur të mos ketë mundësi të qarkullojë për një periudhë kohë kur kjo bimë ka jetëgjatësinë e saj të paktën 6-7 vjet. Ky lloj punimi mund të bëhet një herë në 6 vjet, që besoj se është drejt suksesit. Gjithashtu, po punohet edhe për makineri të tjera të kultivimeve, sepse s'ka fuqi punëtore, si dhe po punohet dhe për makineri të tjera të korrjes dhe makineri të tjera të tharjeve. Pra, do të kemi një paketë të plotë për sa i përket kësaj fushe. Unë mendoj që për të ardhmen ministria e bujqësisë duhet të orientohet në këtë drejtim. Pse?! Sepse është shumë efikase dhe shumë frytdhënëse sa i përket kësaj fushe. Këto na i diktoi koha, sepse se nuk kemi njerëz më.

U tha aty që kanë aplikuar rreth 6 mijë fermerë dhe deri në këtë moment kanë përfituar rreth 3 mijë, në mos gabohem, për subvencionimet, për naftën. Do të doja të dija sa përfitues janë nga Malësia e madhe?

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Lika.

Në fakt, më pëlqeu shumë kjo që ju thatë. Në fakt, nga vizita që ne kemi bërë si komision në Malësinë e Madhe, ne e kemi vënë re këtë gjë dhe kjo shkon edhe me atë që unë kam në kokë, që ne kështu duhet ta konceptojmë edhe bujqësinë. Sigurisht kemi zona, ku duhet dhe të ndërhyjmë në mënyrë të drejtpërdrejtë, sepse kultura bujqësore që prodhojnë, apo copëzimi i terrenit që kanë, nuk i lejon që të rriten, por ne duhet ta shikojmë si një ekonomi, e cila prodhon mirëqenie dhe si një biznes i mirëfilltë. Po nuk e pamë bujqësinë si biznes, por si një ekonomi sociale, që mban disa njerëz në zona të caktuara që të mos lëvizin nga aty, kështu do të ngelet. Ne kemi eksperiencë shumë pozitive, qoftë këto që thatë ju në fushën e bimëve medicinale, qoftë eksperiencat e Jugut të Shqipërisë, qoftë eksperiencat, të cilat kanë të bëjnë me ullirin. A kemi problematika? Sigurisht, që kemi, por në fund fare 1 me 7 eksporti dhe importi 1 me 3 tregon se bujqësia ka një rritje të padiskutuar. A kemi probleme? Po, dhe ka për të qenë gjithmonë sektori me më shumë probleme se të tjerët, sepse është një sektor, i cili kërkon prodhim makinerish të veçanta, kërkon ndryshim mentaliteti, por kërkon që ndonjëherë të dojë edhe pak Zoti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e ka zoti Gështenja.

Lefter Gështenja – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj zotin zëvendësministër dhe zotin Tarelli për ato që na shpjeguan dhe na prezantuan!

Në fakt, unë kam një pyetje për zëvendësministrin: çfarë e ka penguar institucionin tuaj që ju drejtoni, pra ministrinë, në këta 9 vjet që të mos ketë një plan kombëtar për mënyrën se si do të zhvillohet bujqësia, mos keni një strategji, edhe pse kjo është e përcaktuar në kreun II të ligjit nr. 9817/2007, neni 4, kur kërkohet hartimi i planit kombëtar?

Unë mund qesh më vonë, zoti Zëvendësministër, por tani po ju pyes: pra kërkohet strategjia e bujqësisë dhe strategjia e zhvillimit në zona rurale. Çfarë e ka penguar institucionin tuaj që të mos ketë një strategji prej 9 vjetësh? Unë për vete do të skuqesha nëse do të isha shtetar, do të thosha që jemi duke hartuar strategjinë kombëtare 2021/2027, ndërkohë e tha edhe zoti Sharka që sot jemi në vitin 2022, duhet të jemi më seriozë, të paktën këtu në komision.

Gjithashtu, dua të di çfarë modeli keni ndjekur ju si ministri për shpërndarjen e karburantit apo për subvencionet në bujqësi? Cili është modeli? E keni ndarë sipas sipërfaqeve të punuara, apo e keni ndarë sipas përkatësisë politike?

Arben Pëllumbi – Zoti Gështenja, do t'ju lutesha të qëndronim brenda temës.

Lefter Gështenja – Po, po brenda jam.

Arben Pëllumbi – Karburanti nuk ka lidhje fare me këtë temë.

Lefter Gështenja – Në lidhje me atë që zoti Tarelli iu përgjigj kolegut tim, që tha është në sistem në internet, pra mënyra se si shpërndahet karburanti, unë po u citoj: po, është në sistem të paktën vitin e kaluar, po këtë viti akoma jo, por është sipas qarqeve. Pra, nuk identifikohet kush është në Malësi të Madhe apo kush është përfituesi për Librazhdin apo për Përrenjasin, është vetëm e ndarë sipas qarqeve dhe kjo është lehtësisht e vërtetueshme, sepse kam në ekran. Pra, nuk është e detajuar, ndërkohë që flitet vetëm për sasi karburanti, por mbi çfarë baze, mbi çfarë sipërfaqeje, a ka sasi karburanti të përfituar? Përsëri po i referohem zotit Tarelli në lidhje me atë pse nuk merret në konsideratë propozimi i zotit Duka për një kohështrirje 5-vjeçare, jo 1-vjeçare, por 5 -vjeçare e kërkon zoti Duka. Ju thatë se duhet të parashikohet PBA-ja e të tjera. Ndërkohë, përsëri po iu citoj ligjin nr. 9817, i cili thotë: “Plani kombëtar hartohet nga ministria në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave për një periudhë 7-vjeçare, pra bie poshtë ajo që ju thatë se nuk mund të merret në konsideratë propozimi i zotit Duka për një shtrirje me afat kohor 5-vjeçar.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Gështenja!

Në fakt, bujqësia është një element shumë i rëndësishëm i jetës sonë të përditshme dhe, sigurisht, ne jemi kuriozë dhe e shtrijmë aty, duhet të qëndrojmë, përndryshe ne nuk mbarojmë dhe duhet ta hedhim në votë në kohë.

Ju lutem, shkurtimisht, përgjigjet për zotin Gështenja!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Civici, fjala për ju.

Enio Civici – Unë do t’i përgjigjem vetëm pyetjes së parë dhe zoti Tarelli pyetjeve të tjera. Ka ekzistuar strategjia 2014-2020, sipas së cilës ka funksionuar bujqësia dhe nuk ka 9 vjet pa strategji dhe pa dokument udhëzues për politikën që ndërmerren qoftë ekzekutive, qoftë ato diskutime legislative që bëhen në këtë institucion të nderuar. Prandaj, fillon nga 2021 deri në 2027, ndërsa për përgjigjet e tjera zoti Tarelli.

Irfan Tarelli – Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe një herë për sa i përket propozimit për zgjatjen e periudhës së subvencioneve në 5 vjet, parashikimit me ligj dhe qëndrimit në dokumentet strategjike, pra një nga pengesat eventuale në përcaktimin ligjor të kësaj ka të bëjë, siç u tha, edhe me parashikimin buxhetor afatmesëm. Qëndrimi strategjik është korrekt që të mos kemi ndryshueshmëri të masave mbështetëse, le të themi, pse 5 vjet, por 7 vjet apo 9 vjet. Efekti është më i mirë dhe jep sinjale të qarta tregu dhe mbështetje. Pa diskutim që është mirë. Problemi është: teknikisht a e kemi në harmoni me ligjet e tjera? Kjo është pikëpyetja dhe kërkon një diskutim më të thelluar me Ministrinë e Financave edhe për rregullime ose përshtatje eventuale, sepse nuk jam në gjendje ta shpjegoj pozicionin e Ministrisë së Financave sot. Të paktën në draftstrategji ne, pak a shumë, rikonfirmojmë këtë qëndrim në përputhje me qëndrimet që mbahen në politikën e përbashkët të Bashkimit Europian, sepse jemi “të detyruar” ta bëjmë këtë për shkak jo vetëm të orientimit që kemi për t’u bërë pjesë e Bashkimit Europian, por edhe për interesa të mirëfillta tregtare. Pra, në qoftë se themi strategjia e Bashkimit Europian supozon një politikë bujqësore miqësore me mjedisin, me pak mbetje e të tjera, kjo përkthehet në normativa dhe standarde, të cilat duhet t’i prodhojmë dhe t’i aplikojmë detyrimisht edhe ne, në të kundërt, nuk ke akses tregtimi në vendet Bashkimit Europian. Pra, në këtë kuptim, dokumenti që ne po përpunojmë, duhet të jetë detyrimisht në harmoni me dokumente të tilla më gjerë se ne, ose politika e përbashkët e peshkimit, fjala vjen. Një tjetër problem që kemi, i cili lidhet me subvencionet, ka të bëjë me formalizimin e bujqësisë. Në qoftë se ne mbajmë qëndrime detyruese në ligj, me një bujqësi informale, janë dy shina që nuk shkojnë me njëra-tjetrën. Ne kemi një trend pozitiv, të paktën në 2 vjetët e fundit, ku

para se të fillonte skema e shpërndarjes së naftës në fillim të vitit 2021, ne kishim vetëm 47 mijë fermerë me NIPT, ku përfshihet edhe blegtoria.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pa diskutim.

Sot kemi rreth 80 mijë. Përsëri ky nuk është një numër i mjaftueshëm që të përfshijë të gjithë fashën e bujqësisë që del për treg. Pra, janë disa zhvillime që duhet të ndodhin në të njëjtën kohë dhe duhet të pasqyrohen edhe në aktet ligjore përkatëse. Vijnë te problemi i naftës, çfarë qëndrimi është mbajtur? Në fakt, për të aplikuar skemën e naftës është bërë një studim edhe me përfshirjen e Universitetit Bujqësor dhe janë shqyrtuar 4-5 modele. Modeli më i mirë që përdoret sot në vendet e Bashkimit Europian është rimbursim për naftë të blerë kundrejt faturave, për shkak se ne nuk kemi ende ekonomi formale në bujqësi. Kjo skemë nuk do të zbatohet dhe përfitues do të ishin jo më shumë se 1 mijë subjekte, pra që kanë marrëdhënie të qarta me qendrën e regjistrimit, që dokumentojnë procesin. Pra, që këtu apriori ne do të hiqim dorë nga kjo skemë, ndryshe nuk do ta bënim të aplikueshme; mbajtëm qëndrimin fermerëve me NIPT e para, por mbajtëm edhe një qëndrim tjetër që të kemi një minimum parcelash, ku mekanizimi ndodhet realisht në të kundërt, nafta nuk do të shkonte për qëllime bujqësore, por do të përdorej për çdo gjë tjetër dhe është mbajtur qëndrimi: parcela jo më e vogël se një dynym dhe sipërfaqja minimale e fermës që bën punime të mekanizuara 0,4 hektarë , pra 4 dynym. Domethënë, pragu le të themi i poshtëm nga pikëpamja ekonomike nuk do të kishte më kuptim. Vitin e parë, që ishte viti 2021, patëm rreth 20 mijë aplikime; u plotësua, le të themi, thuajse aplikime të vlefshme, thuajse të gjitha, kurse sivjet kemi dyfishin e aplikimeve, u shtua fondi. Domethënë, nga 950 milionë që kaluan me ligjin për buxhetin, Këshilli i Ministrave me akt normativ ka shtuar edhe 500 milionë të tjera si adresim edhe të situatës së krizës pas konfliktit në Rusi dhe Ukrainë, do të shikojmë nëse do të akomodojmë të gjithë përfituesit apo jo, por është gjykuar një skemë që shkon me kushtet tona, për hir të së vërtetës është një kopjim, është një miksim që shkon më mirë me realitetin tonë, nuk ka kontestime nga fermerët. Pra, lehtësia është në ekstremin e saj, mjafton një aplikim, i asistuar nga zyrat tona, nga zyrat e pushtetit vendor, pa asnjë paragjykim. Sistemi mundëson transparencë të plotë, jo ju si deputetë që keni të gjithë aksesin, por çdo qytetar mund të informohet në kohë reale për gjithçka. Ajo që iu referoj për vitin e kaluar është publikimi i listës përfundimtare të përfituesve, pra ka zero kontestim nga përfituesit dhe nga aktorë të tjerë. Pjesa tjetër është në proces; AZHBR-ja po bën të njëjtën gjë, pra shpall listën e aplikantëve dhe shpall listën e përfituesve me sasi të respektive të përfitimit.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Me sa kuptova, nëse është e mundur, kolegët pyetën edhe që ta kenë jo për qark apo për rajon, por ta kenë të detajuar edhe përfituesin për bashki. Kështu, nëse është mundur, por kjo është një marrëdhënie tjetër.

Urdhëroni!

Ismet Beqiraj – Unë nisem nga fjala e fundit që në lidhje me skemën e subvencionimit në bujqësi për subvencionimin e karburantit nuk ka vërejte nga fermerët. Në rregull, po për skemën e subvencionimit të ullirit, çfarë është zgjedhur, për numër rrënjë, për njësi hektarë ose dynym, apo sipërfaqe toke?

Së dyti, është miratuar edhe ligji për transferimin e pronës në vitin 2020, që lidhet kryesisht jo vetëm me riazhurnimin e tokave bujqësore, sipas ligjit nr. 7501, i cili zgjidh shumë probleme të këtyre 30 vjetëve që ka reforma e tokës, por edhe për tokat informale që gjatë kësaj periudhe ish-komunat ose bashkitë ose me forma të tjera i kanë përvetësuar fermerët. Pra, atje ku ka pasur arën ai, ka marrë një tokë informale dhe me konceptin e vlerësimit të njëtrajtshëm, ashtu siç u bë edhe për legalizimet e ndërtimit, në njëfarë mënyre ky ligj legalizon, me kushte të caktuara edhe këto toka, që sot i kanë mbjellë ullinj dhe vreshta, pra i kanë zhvilluar. Te skema e mbështetjes ata, edhe pse kanë zhvilluar tokat e informale që kanë fermerët, frenohen, as tokat që kanë marrë për 99 vjet nga ish-komunat me qira, por edhe këto toka; këta penalizohen, sepse, tek e fundit, t e kanë zhvilluar këtë pronë...

Arben Pëllumbi – Ju lutem, zoti Beqiraj, përmbylleni se jemi jashtë temës! Atë që iu kërkova kolegëve të opozitës, do t'jua kërkoj edhe juve. Këto janë tema, të cilat na prekin të gjithë, jemi të gjithë të interesuar, por nuk janë pjesë e kësaj seance dhe nuk na mjafton një seancë për t'i sqaruar.

Tani, po pati mundësi, një përgjigje të shkurtër, në respekt të pyetjeve të zotit Beqiraj!

Irfan Tarelli – Shqetësimi është shumë i drejtë, por lidhet me pjesën e paformalizuara të bujqësisë. Në fakt, edhe vitin e kaluar, edhe sivjet ne kemi bërë disa ndryshime në udhëzimin përkatës që administron dhe kemi krijuar mundësinë që edhe marrëdhëniet informale që fermeri ka me tokën, por praktikisht është mbjellë me një konfirmim të njësisë administrative, të krijohet mundësia e përfitimit. Pra, me vetëdeklarim, koncepti është vetëdeklarim, një normë e fiksuara edhe me vendimin e qeverisë dhe konfirmim përkatës nga njësi administrative. Pra, është bërë përfshirja më e mundshme edhe në çdo situatë hipotetike, le të themi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Këtu i mbyllim diskutimet.

Kalojmë në procesin e votimit në parim të propozimeve të bëra në projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural””, nismë e kolegut, zotit Duka.

Kush është dakord me propozimin e zotit Duka në parim? 5 vota pro. Kundër?
Abstenim?

Nisma nuk kalon.

Faleminderit të gjithëve për kontributin!

Faleminderit, zoti Duka!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA